

Nr. _____ Prot.

Berat, me 23.11.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 23.11.2020

Për: “ENBI POWER” sh.p.k me nipt: K47905860J, adrese: Rruga Kavajës, Kompleksi 100 Vitrinat, Kulla 2, Kati 3, Tirane.

Procedura e prokurimit: E hapur- Pune

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72868-09-24-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndertimi i Kabines se re ne Molisht 2 Fideri nr. 24 6 kV dhe Ndertim i Fiderit A6B, 6/20 kV N/Stacioni Burdullias 110/20 kV i kabinave dhe rrjetit TU me kabell ABC”, me fond limit: 52 310 939 (pesedhjetë e dy milion e treqind e dhjetë mijë e nentëqind e tridhjetë e nente) leke pa tvsh. Kohezgjatja është 100 dite nga dorezimi i sheshit të ndertimit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): JO

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 77, datë 28 .09. 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “EN-EL” shpk me NIPT: L22405011A

Vlera: 0 (zero) leke

2. BOE: “Totila” sh.p.k, (NIPT: K13001010G) “Ed Konstruksion” sh.p.k (NIPT: K61625001I) & “Beqiri” sh.p.k (NIPT: J98624801V)

Vlera: 40, 559 ,246 (dyzet milion e pesëqind e pesëdhjetë e nente mijë e dyqind e dyzete e gjashtë) leke pa tvsh

3. “ENBI POWER” sh.p.k me nipt: K47905860J

Vlera: 52,037,791 (pesedhjetë e dy milion e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e netëdhjetë e një) leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “EN-EL” shpk me NIPT: L22405011A
2. BOE: “Totila” sh.p.k, (NIPT: K13001010G) “Ed Konstruksion” sh.p.k (NIPT: K61625001I) & “Beqiri” sh.p.k (NIPT: J98624801V)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. EN-EL shpk me NIPT: L22405011A, Ky operator ekonomik ka paraqitur si dokument vetem nje Formular Oferte pa vlere fare (bosh) dhe nje Ekstrakt Historik te regjistrimit themeltar. Asnje dokument tjetër.

Ne Dokumentat Standarte te Tenderit, ne shtojcen 12 eshte cituar: Rastet e mosparaqitjes te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kusht per skualifikim.

Operatoret ekonomike janë te detyruar te përgatisin oferta ne përputhje me kërkesat e përcaktuara ne dokumentat e tenderit, ne menyre qe edhe vleresimi te behet ne perputhje me kete dokumentacion. Mosplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme.

Ne nenin 46 te ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 per “Prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin Nr.9800, date 10.09.2007, ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, dhe ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, ligjin nr.131 dt. 27.12.2012 dhe Ligjin Nr. 182/20141 parashikohet se “Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme”

2. BOE: “Totila” sh.p.k, (NIPT: K13001010G) “Ed Konstruksion” sh.p.k (NIPT: K61625001I) & “Beqiri” sh.p.k (NIPT: J98624801V), ky bashkim operatorësh nuk kane paraqitur marreveshjen e bashkepunimit sipas ligjit.

Nga shqyrtimi i dokumntacionit te paraqitur nga keto kompani eshte konstatuar se ky bashkim opratoresh nuk eshte krijuar ashtu ciç e kerkon legjislacioni ne fuqi per prokurimin publik ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomik.

Ne baze te nenit 74 te Vendimi te Keshilit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar , citon:

Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Ne shtojcën nr. 12 të Dokumentave Standarte të Tenderit, të kriteret e përgjithshme të kualifikimit citohet: “nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë,

duhet të dorëzohen :

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Nga sa me sipër rezulton se ky BOE të sipër cituar, nuk kanë paraqitur marrëveshjen për bashkëpunim në të cilën përcaktohen pjesët e punës që do të kryejë çdo pjesëtar i grupit dhe prokurën e posaçme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ENBI POWER” sh.p.k me nipt: K47905860J, adresë: Rruga Kavajës, Kompleksi 100 Vitrinat, Kulla 2, Kati 3, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 52,037,791 (pesëdhjetë e dy milion e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e netëdhjetë e një) leke pa tvsh /pikët totale të marra [100] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtoria Rajonale OSSH, Berat Adresa: Rr. “Antipatrea” pranë Gjykates, Berat Tel/Fax: 0693422778 E-mail: armlaziali@yahoo.com sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do të anulohet ashtu siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.11.2020

Ankesa: JO

[Titullari i autoritetit kontraktor]